



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE

Nr. 20(M) 2023 i Regjistrimit Themeltar

Nr. 283 i Vendimit

V E N D I M

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Sonila Bejtja, Anëtare

Fiona Papajorgji, Anëtare

në datën 28.12.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 20(M) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** MARTIN MAROCI, përfaqësuar nga avokat Ermir Beta.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 329, datë 14.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. 268, datë 26.04.2017 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2023-1193, datë 26.04.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 30, 32, pika 2, 42 dhe 131, shkronja “f”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Martin Maroci (*kërkuesi*) është dënuar për veprat penale “Vrasja me paramendim”, e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 78-25 dhe 278, pika 2, të Kodit Penal (*KP*), për vrasjen e shtetasit A.Gj., i cili në datën 24.11.1997 është gjetur i pajetë në qytetin e Athinës/Greqi. Sipas dokumenteve në dosjen gjyqësore, kërkuesi në vitin 2002 ka ndryshuar mbiemër nga Çupi në Maroci.

2. Për të ndjerin A.Gj. në vitin 1996 Prokuroria pranë Rrethit Gjyqësor Mirditë kishte regjistruar procedimin penal nr. 213/1996 për veprën penale “*Vrasja me paramendim*” të shtetasit Ll. Ç., të parashikuar nga neni 78 i KP-së, pasi nga një përleshje me të dhe shtetasin M.N., të cilët kanë tentuar ta vjedhin, janë shkëmbyer të shtëna me armë zjarri e për rrjedhojë është plagosur për vdekje shtetasi Ll.Ç. vëllai i kërkuesit. Duke qenë se A.Gj. ka ndërruar jetë në shtetin grek, në datën 27.12.1997, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “ë”, të Kodit të Procedurës Penale është pushuar çështja në ngarkim të tij.

3. Në datën 26.08.1998, mbi denoncimin e nënës së A.Gj., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë ka regjistruar procedimin penal nr. 87 për veprat penale të parashikuara nga nenet 78-25 dhe 278, pika 2, të KP-së. Në datën 25.06.2000 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë, duke qenë se nga autoritetet greke nuk kishte një përgjigje për kërkesën e organeve shqiptare në lidhje me vënien në dispozicion të akteve përkatëse për këtë ngjarje, ka vendosur pushimin e procedimit penal bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “dh”, të KPP-së.

4. Në lidhje me këtë ngjarje, fillimisht autoritetet greke kanë hetuar duke marrë dëshmi të ndryshme, ndër to edhe të vëllait të të ndjerit që jetonte në Greqi, i cili ka dëshmuar se në vitin 1996 A.Gj. ka plagosur për vdekje me armë zjarri shtetasin Ll.Ç. Nga hetimet nuk kanë rezultuar të dhëna se A.Gj. ka pasur probleme me persona të tjerë. Autoritetet greke kanë përjashtuar pistën e vrasjes me qëllim grabitjen e tij apo të vetëvrasjes dhe i kanë shtrirë hetimet mbi kërkuesin dhe vëllain e tij, autorë të mundshëm të vrasjes së të ndjerit, me arsyetimin se këta shtetas duhet të kenë vepruar për t’u hakmarrë për vrasjen e vëllait të tyre në vitin 1996. Për ta nga gjykata greke janë lëshuar

edhe vendime arresti. Në vijim, në vitin 2009, çështja është transferuar në Shqipëri, në ngarkim të dy vëllezërve Martin dhe Pal Çupi.

5. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar procedimin penal nr. 96, datë 25.02.2010 në ngarkim të Pal Çupit, vëllait të kërkuarit, dhe me vendimin e datës 25.11.2011 ka vendosur të pushojë çështjen për moszbulim të autorit të veprës penale.

6. Prokurori i Përgjithshëm, me cilësinë e prokurorit më të lartë, me vendimin e datës 21.09.2014, mbi bazën e ankimit të familjarëve të të ndjerit A.Gj. (*referuar dosjes gjyqësore*), ka shfuqizuar vendimet e pushimit të procedimit penal nr. 87/1998 dhe nr. 96/2010, si të pambështetura në prova dhe ligj, duke urdhëruar bashkimin e tyre dhe vazhdimin e hetimeve. Për rrjedhojë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në datën 24.09.2014 ka vendosur rifillimin e hetimeve për veprat penale të parashikuara në nenet 78-25 dhe 278, pika 2, të KP-së, me të dyshuar kërkuarin dhe vëllain e tij, dhe ka vijuar me kërkesën për gjykimin e saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Kërkuari është arrestuar në datën 01.04.2016, duke iu nënshtruar masës së sigurimit “Arrestimi në burg”, ndërsa vëllai i tij është gjykuar në mungesë.

7. Me vendimin nr. 329, datë 14.11.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “Vrasja me paramendim” dhe bazuar në nenin 78 të KP-së, dënimin e tij me 20 vjet burgim, pushimin e çështjes në ngarkim të tij për veprën penale të parashikuar në nenin 278, pika 2, të KP-së për shkak të parashkrimit, si dhe deklarinimin të pafajshëm të pandehurinjve tjetër, vëllain e kërkuarit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim i pandehurinjve dhe prokurori për vendimin për pafajësinë e vëllait të kërkuarit.

8. Me vendimin nr. 268, datë 26.04.2017, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke e gjetur atë të drejtë, të bazuar në ligj e në prova. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs i pandehurinjve dhe prokurori.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1193, datë 26.04.2023, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja “e”, të KPP-së, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

10. Në datën 12.10.2023 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, sipas objektit të kërkesës.

## II

### Pretendimet e kërkuarit

11. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

11.1. *Sigurisë juridike*, pasi vendimi i prokurorit më të lartë ka riçelur dy procedime penale, të cilat janë pushuar me arsyetimin se nuk kishte akte dhe prova të mjaftueshme për ngritjen e akuzës ndaj të dyshuarve, duke i bashkuar në një të vetëm 3 vjet pas marrjes së vendimit të pushimit, pa asnjë provë apo rrethanë të re, por vetëm për një vlerësim të ri të provave, duke krijuar pasigurinë ligjore që prokurori më i lartë në çdo rast mund të hapë një procedim penal për të cilin është vendosur më parë pushimi i tij. Në pikën 5 të nenit 24 të KPP-së së kohës, prokurori më i lartë mund të ndryshonte vendimin e prokurorit më të ulët me ankim ose kryesisht. Neni 329 i KP-së në fuqi në atë kohë, gjithashtu, parashikonte filtrin e kontrollit ligjor ndaj vendimit të pushimit të prokurorit. Për çështjen në fjalë nuk ekziston asnjë vendim gjykatë që ka prishur apo shfuqizuar vendimin e pushimit të prokurorit, në këto kushte vendimet kanë marrë “formë të prerë” dhe asnjë prokuror nuk mundet të ndryshojë këtë cilësi me një vendim tjetër. Ai duhet të ushtronte një prej mjeteve të ankimit të parashikuara në nenin 407 të KPP-së në rast se do të kishte prova të reja.

11.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi personat që kanë dëshmuar janë pyetur në vitin 1999, dhe mbi atë bazë prokurori kishte vendosur pushimin e çështjes. Pas 16 vjetësh nga momenti kur është regjistruar çështja nuk mund të gjykohet për të dhëna të cilat nuk mund të kundërshtohen, pasi dëshmitarët kishin ndruar jetë. Të pandehurit në këtë mënyrë nuk i është dhënë mundësia të kundërshtojë vërtetësinë e provave dhe përdorimin e tyre.

11.3. *Marrjes së provës në mënyrë të paligjshme*, pasi vendimet e gjykatave janë marrë në zbatim të gabuar të neneve 151, 152, 154 dhe 166 të KPP-së, si dhe neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës. Gjykatat kanë pranuar fajësinë e të pandehurit vetëm se atij i ngarkohet nga deklarimet e të tretëve një telefonatë në vitin 1997 me të atin gjatë së cilës i ka rrëfyer vrasjen. Ky standard i pranuar në vendimet e gjykatave nuk ka asnjë lidhje me atë të bindjes përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Kjo telefonatë asnjëherë nuk është verifikuar dhe as provuar. Edhe babai i të pandehurit, kur është pyetur, ka

deklaruar se nuk kishte dijeni se kush e ka vrarë të ndjerin A.Gj. Thëniet e të pandehurit që janë marrë nga gjykata e rrethit dhe ajo e apelit, si dëshmi indirekte, janë në kundërshtim të hapur me parashikimet e neneve 154 dhe 166 të KPP-së. Kur një person deklaron te persona të tjerë thëniet e të pandehurit, jemi para marrjes së thënieve të të pandehurit në kundërshtim me ligjin dhe konsiderohen prova të marra në mënyrë të paligjshme, për këtë arsye nuk mund të përdoren. Në rastet përjashtimore, siç është vdekja e dëshmitarëve, thëniet për faktet mund të përdoren vetëm si indicie. Kur burimi i provës nuk ka qenë i pranishëm në vendngjarje, ai nuk mund të konsiderohet dëshmitar. Bazuar në nenin 154, pika 2 të KPP-së, personi i cili është burimi i dëshmisë duhet thirrur për të verifikuar përmbajtjen e dëshmisë, por në rastin konkret është vetë i pandehuri dhe pozita e tij në gjykim është e papajtueshme me pozitën e dëshmitarit, pasi në cilësinë e të pandehurit ai i kundërshton ato.

11.4. *Parimit të prezumimit të pafajësisë dhe in dubio pro reo*, pasi jo vetëm që nuk është provuar plotësisht asnjë nga rrethanat e pretenduara nga akuza, por nuk ka asnjë provë që të vërtetojë fajësinë e tij. Organi i prokurorisë ka barrën e provës dhe i pandehuri prezumohet i pafajshëm deri sa provohet akuza nëpërmjet një analize të hollësishme, të plotë e të gjithanshme. Një person nuk mund të deklarohet fajtor nëse nuk janë provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të gjitha elementet e veprës penale, pasi çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Dyshimi në favor të të pandehurit nënkupton se kur faktet dhe rrethanat e çështjes lejojnë vlerësime e interpretime të ndryshme, duhet pranuar ai interpretim që është më i favorshëm për të pandehurin. Nga prokuroria dhe nga gjykatat është marrë e mirëqenë që i pandehuri ka qenë në Greqi në kohën që ka ndodhur ngjarja, megjithëse diçka e tillë nuk rezulton e provuar. Gjykata e apelit, në shkelje të këtij parimi, është shprehur se edhe pse “*për periudhën që është kryer vrasja nuk ka informacion zyrtar për lëvizjet e shtetasve, kjo nuk e përjashton mundësinë e lëvizjes në mënyrë të paligjshme*”. Gjithashtu, e paprovuar rezulton edhe telefonata që supozohet t’i ketë bërë të atit, ku ka pranuar kryerjen e kësaj vepre, pasi nuk ka asnjë tabulat telefonik, asnjë fotografi, asnjë dokument që të mbështesë këtë fakt, pa të cilin bie e tërë ngrehina e akuzës. Çdo dyshim është bazuar në deklaratimet e dhëna

nga vëllai i të ndjerit përpara autoriteteve greke. Ngjarja është paragjykuar, duke përjashtuar çdo pistë tjetër apriori dhe duke u fokusuar te gjakmarrja. Dëshmia indirekte, si një nga rastet e nenit 154, pika 2, të KPP-së, nuk përbën provë, sepse ajo nuk mund të verifikohet, për këtë arsye ajo konsiderohet indicie, por kjo indicie duhet të konkurrojë me elemente të tjera për të provuar fajësinë. Neni 154 i KPP-së parashikon për dëshmitarin që u referohet personave të tjerë se gjykata duhet të urdhërojë thirrjen e tyre për të dëshmuar, pra parashikon pyetjen e personit të cilit i referohet dëshmitari indirekt. Dëshmitarët, të cilëve babai i të pandehurit u ka rrëfyer se veprën penale e ka kryer djali i tij, kanë ndërruar jetë.

11.5. *Evidentimit të ometimit legjislativ në nenin 24, pika 5, të KPP-së në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes dhe interpretimit të normës në përputhje me parimet kushtetuese, pasi ekzistenca e normave ligjore të paqarta, të paplota dhe kontradiktore të shkaktuara nga zbrazëtia e vetë ligjit, është aspekt i shfaqjes së ometimit legjislativ, i cili mund të ndikojë në antikushtetutshmërinë e tij. Konkretisht, neni 24, pika 5, i KPP-së ka qenë dispozitë e paqartë dhe e paplotë, pasi në të nuk përcaktohet afat ankimi ndaj vendimit të pushimit të çështjes, nuk përcaktohet mënyra dhe afati i ligjshmërisë së vendimit të pushimit të çështjes nga prokurori më i lartë, si dhe nuk përcaktohen rastet dhe shkaqet e shfuqizimit të vendimit të pushimit të çështjes.*

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së

kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi dhe është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, referuar neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, duhet që individi t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kolegji konstaton se kërkuesi kundërshton vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimeve të gjykatës së rrethit dhe të apelit, duke përmbyllur në këtë mënyrë procesin gjyqësor penal në ngarkim të tij, për rrjedhojë kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendon se i janë shkelur.

16. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 26.04.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 12.10.2023. Nga informacioni zyrtar i Gjykatës së Lartë drejtuar kërkuesit, vendimi është bërë i disponueshëm për palët në datën 31.08.2023, për rrjedhojë kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

17. Lidhur me legjitimitetin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike, të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, cenimin e parimit të marrjes së provës në mënyrë të paligjshme, cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë (*in dubio pro reo*) dhe evidentimin e ometimit legjislativ të pikës 5 të nenit 24 të KPP-së në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes. Për sa i takon pretendimit të fundit, në jurisprudencën kushtetuese lidhur me kontrollin kushtetues të akteve të shfuqizuara, është theksuar se, si rregull, normat juridike i nënshtrohen

kontrollit kushtetues nëse janë në fuqi në kohën e kontrollit. Përjashtimisht, kontrollit kushtetues i nënshtrohen edhe normat juridike të shfuqizuara, kur këto, si pjesë e së drejtës pozitive, duhet të zbatohen për rregullimin e pasojave juridike që zgjasin në kohë dhe janë të lidhura me ekzekutimin periodik ose me afat të detyrimeve juridike civile që rrjedhin nga marrëdhënie juridike të krijuara në kohën e ligjit të shfuqizuar (*shih vendimet nr. 4, datë 08.02.2023; nr. 38, datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se referuar nenit 24, pika 5, të KPP-së në fuqi përgjatë kohës së hetimit të çështjes ndaj kërkuesit, prokurori më i lartë kishte kompetencë të riçelte hetimin penal, dispozitë kjo e cila ka gjetur zbatim edhe në rastin e tij, në përputhje me parimin *tempus regit processum*. Ndryshimet e KPP-së me ligjin nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” të cilat prekën edhe nenin 24 të tij, reflektuan zgjedhjen e legjislatorit për të ndryshuar strukturën e organit të prokurorisë në tërësi (*decentralizimin e tij*) dhe jo nevojën për qartësimin apo plotësimin e saj.

19. Bazuar në standardet kushtetuese të lartpërmendura, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë argument kushtetues, nëse ndodhet para rasteve përjashtimore që do të bënin të mundur që dispozita t’i nënshtrohej kontrollit kushtetues. Për rrjedhojë, pretendimi në lidhje me antikushtetutshmërinë e pikës 5 të nenit 24 të KPP-së së kohës, nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak se prokurori më i lartë ka riçelur dy procedime penale, të cilat janë pushuar me arsyetimin se nuk ka pasur akte dhe prova të mjaftueshme për ngritjen e akuzës ndaj të dyshuarve, Kolegji vlerëson se ai, në thelb, ka të bëjnë me zbatimin e ligjit procedural nga prokuroria, çka nuk i përket juridiksionit kushtetues, prandaj edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura në ankimin kushtetues individual, konkretisht cenimin e parimit të marrjes së provës në mënyrë të paligjshme, të prezumimit të pafajësisë (*in dubio pro reo*) si dhe të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, ato *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues dhe do të analizohen në vijim.

#### *B. Për pretendimin e cenimit të parimit të marrjes së provës në mënyrë të ligjshme*

22. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e gjykatave janë marrë në zbatim të gabuar të neneve 151, 152, 154 dhe 166 të KPP-së, si dhe neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës. Gjykatat kanë



pranuar fajësinë e të pandehurit vetëm se atij i ngarkohet nga deklaratimet e të tretëve, një telefonatë në vitin 1997 me të atin gjatë së cilës i ka rrëfyer vrasjen. Ky standard i pranuar në vendimet e tyre nuk ka asnjë lidhje me atë të bindjes përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Kjo telefonatë asnjëherë nuk është verifikuar dhe as provuar. Edhe babai i të pandehurit, kur është pyetur, ka deklaruar se nuk ka pasur dijeni se kush e ka vrarë të ndjerin A.Gj. Thëniet e të pandehurit që janë marrë nga gjykata e rrethit dhe ajo e apelit, si dëshmi indirekte, janë në kundërshtim të hapur me parashikimet e neneve 154 dhe 166 të KPP-së. Kur një person deklaron te persona të tjerë thëniet e të pandehurit, jemi para marrjes së thënieve të të pandehurit në kundërshtim me ligjin dhe konsiderohen prova të marra në mënyrë të paligjshme, për këtë arsye nuk mund të përdoren. Në rastet përjashtimore, siç është vdekja e dëshmitarëve, thëniet për faktet mund të përdoren vetëm si indicie. Kur burimi i provës nuk ka qenë i pranishëm në vendngjarje, ai nuk mund të konsiderohet dëshmitar. Bazuar në nenin 154, pika 2, të KPP-së personi i cili është burimi i dëshmisë duhet thirrur për të verifikuar përmbajtjen e dëshmisë, por në rastin konkret është vetë i pandehuri dhe pozita e të tij në gjykim është e papajtueshme me pozitën e dëshmitarit, pasi në cilësinë e të pandehurit ai i kundërshton ato.

23. Në referim të nenit 32, pika 2, të Kushtetutës askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Në këtë drejtim, detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë. Për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre (*shih vendimin nr. 57, datë 21.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata në jurisprudencën e saj ka evidentuar dallimin që ekziston midis mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre në procesin gjyqësor. Vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete janë, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të kësaj Gjykate. Gjykatat e zakonshme, kur kryejnë detyrën e vlerësimit të provave, mund të binden mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ato i konsiderojnë të parëndësishme për çështjen. Bazuar në dispozitat procedurale, çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit e nuk ka vlerë të paracaktuar dhe gjykata i vlerëson ato sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi. Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal, pasi sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues e bën procesin gjyqësor

të parregullt nga pikëpamja kushtetuese (*shih vendimin nr. 9, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë i ka vlerësuar pretendimet e kërkuesit si të pabazuara, me arsyetimin se vendimi i saj bazohet në dëshmitë e autoriteteve greke të hetimit, ku sipas materialit të referuar nga ato, në periudhën e vrasjes së të ndjerit i pandehuri ndodhej në Greqi dhe ishte shprehur se do të hakmerrej sipas zakonit për vrasjen e vëllait të tij. Për gjykatën dërgimi i fjalës ditën e varrimit të të ndjerit prej babait të kërkuesit se të ndjerin e ka vrarë djali i tij, por edhe dëshmitë e të afërmve, të cilët kanë qenë prezentë dhe i kanë dëgjuar këta shtetas, janë prova indirekte të cilat lidhen mes tyre, konfirmojnë dhe mbështesin njëra-tjetrën nga pikëpamja logjike. Sipas gjykatës, është e pamundur që dëshmitarët P.B., Gj.B. dhe D.Sh, të cilët janë pyetur gjatë gjykimit në vitin 1998, të kenë shkuar pa autorizim për të dërguar fjalë në shtëpinë e viktimës për autorin e vrasjes. Zakoni dhe rregullat e forta të traditës në lidhje me vrasjen në komunën Fan, Mirditë, në të cilën kanë banuar i ndjeri dhe të pandehurit, luajnë forcë të madhe. Nga ana tjetër, vrasja e të ndjerit ka ndodhur në vitin 1997, periudhë në të cilën është shpallur gjendja e jashtëzakonshme në Shqipëri, e cila u shoqërua me mosfunksionimin e një pjese të rëndësishme të institucioneve, ndër to dhe të Policisë Kufitare. Për rrjedhojë, nga të dhënat e hyrje-daljeve të pikave të kalimit kufitar nuk ka informacion zyrtar për sa i përket kalimit kufitar të këtyre shtetasve. Po kështu, i pandehuri gjatë gjykimit, nuk ka paraqitur asnjë provë, e cila do të ishte e aftë të vërtetonte praninë fizike të tij në një vend tjetër jashtë territorit të shtetit grek (*shih faqen 8 të vendimit nr. 329, datë 14.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë*).

26. Në vijim këto pretendime të kërkuesit janë shqyrtuar dhe arsyetuar edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër, e cila ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke argumentuar se gjykatat bazohen kryesisht në dëshmitë indirekte të dhëna nga shtetasit P.B., Gj.B., D.Sh. dhe Gj.Gj., të cilët, për shkak se kanë ndërruar jetë gjatë gjykimit të çështjes, marrja e dëshmisë së tyre në gjykatë është bërë e mundur vetëm bazuar në nenin 369 të KPP-së. Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme dhe mosfunksionimi i pikave kufitare në periudhën që ka ndodhur vrasja krijonte mundësinë e lëvizjes në mënyrë të paligjshme të shtetasve. Edhe për gjykatën e apelit dërgimi i fjalës te familja e të ndjerit në ditën e varrimit duhet vlerësuar objektivisht, duke i dhënë vlerë provuese si provë indirekte, pasi kjo mënyrë njoftimi për kryerjen e vrasjes njihet nga e drejta zakonore, që gjen zbatim në krahinat nga të cilat janë autori dhe viktimat (*shih faqen 11 të vendimit nr. 268, datë 26.04.2017 të Gjykatës së Apelit Shkodër*).

27. Në vlerësim të ligjshmërisë së vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta, Gjykata e Lartë, duke analizuar problematikën dhe kompleksitetin e çështjes, në mbështetje të vendimeve të gjykatave të faktit, ka bërë interpretim të neneve 152, 154 dhe 166 të KPP-së, duke arsyetuar se pretendimi për papërdorshmërinë e deklarimeve të dëshmitarëve, të afërm të viktimës, në cilësinë e lajmësve, është i pabazuar. Në kushtet kur këto dëshmi kanë burim referimi deklarimet e kërkuarit, mund të merren vetëm konform nenit 166 të KPP-së dhe dëshmia indirekte e dëshmitarit në të cilën burimi primar përfaqësohet nga deklarimet e bëra spontanisht nga i pandehuri, jashtë kontekstit të një procedimi penal, është e pranueshme për sa kohë që përmbajtja e nenit 36 të KPP-së nuk ndalon deklarimet me përmbajtje (vetë) rrëfyese tek subjekte të paautorizuara institucionalisht. Për rrjedhojë, vendimmarrjet e gjykatave të faktit që lidhen me deklarimet e dëshmitarëve të cilët kanë ndërruar jetë, të përfshira në fashikullin e gjykimit përmes procedurës së leximit, janë në përputhje me nenin 369 të KPP-së duke konkluduar se gjykatat e faktit kanë arsyetuar me të gjitha rekuizitat e vlefshmërisë së sipërcituar (*shih faqen 17 të vendimit nr. 00-2023-1193, datë 26.04.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

28. Për sa më lart, Kolegji vëren se kërkuari nëpërmjet përfaqësuesit të tij i ka ngritur pretendimet në lidhje me mënyrën e marrjes së provave përpara gjykatave të zakonshme, pra atij i është dhënë mundësia të vërë në dukje mangësitë e tyre, si dhe të kundërshtojë ligjshmërinë e tyre në gjykatat e zakonshme. Këto pretendime të kërkuarit rezultojnë se janë shqyrtuar dhe kanë marrë përgjigje nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Referuar dosjes gjyqësore të administruar për nevoja të shqyrtimit kushtetues, rezultojnë, gjithashtu, se gjykatat e zakonshme i kanë mbështetur vendimet e tyre jo vetëm në provat e kundërshtuara si të pavlefshme nga kërkuari, por edhe në një sërë provash të tjera të administruara gjatë gjykimit.

29. Në këtë kontekst rrethanash, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuarit, në thelb, kanë të bëjnë me mënyrën e vlerësimit të provave dhe jo me mënyrën e marrjes së tyre, gjë e cila është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndaj Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të marrjes së provës në mënyrë të ligjshme është haptazi i pabazuar.

### *C. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë (in dubio pro reo)*

30. Kërkuari ka pretenduar se nuk është provuar plotësisht asnjë nga rrethanat e pretenduara nga akuza dhe nuk ka asnjë provë që të vërtetojë fajësinë e tij. Nga prokuroria dhe nga gjykatat është marrë e mirëqenë që ka qenë në Greqi në kohën që ka ndodhur ngjarja, megjithëse kjo nuk

rezulton e provuar apo e thënë nga dëshmitë e dëshmitarëve. Në shkelje të këtij parimi, gjykata e apelit është shprehur se sipas hyrje-daljeve të pikave të kalimit kufitar në periudhën që është kryer vrasja nuk ka informacion zyrtar për lëvizjet e shtetasve, por kjo nuk e përjashton mundësinë e lëvizjes në mënyrë të paligjshme. Telefonata që supozohet t'i ketë bërë të atit për pranimin e kryerjes së veprës penale nuk është provuar, pasi nuk ka asnjë tabulat telefonik, fotografi ose dokument që të mbështesë këtë fakt. Kjo mangësi është mbushur me paragjykime kanunore. Çdo dyshim është bazuar në deklaratimet e dhëna nga vëllai i të ndjerit përpara autoriteteve greke, përfshirë edhe telefonatën e kërkuesit bërë të atit. Ngjarja është paragjykuar, duke përjashtuar çdo pistë tjetër apriori dhe duke u fokusuar tek gjakmarrja. Dëshmia indirekte, si një nga rastet e nenit 154, pika 2, të KPP-së, nuk përbën provë, pasi nuk mund të verifikohet. Për këtë arsye, ajo konsiderohet indicie, e cila duhet të konkurrojë me elemente të tjera për të provuar fajësinë. Neni 154 i KPP-së parashikon se për dëshmitarin që u referohet personave të tjerë, gjykata duhet të urdhërojë thirrjen e tyre për të dëshmuar, pra pyetjen e personit të cilit i referohet dëshmitari indirekt. Dëshmitarëve, të cilëve babai i të pandehurit u ka thënë se vepra penale është kryer nga djali i tij, kanë ndërruar jetë.

31. Kolegji thekson se në referim të nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykata në jurisprudencën e saj e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimin nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Duke mbajtur në konsideratë standardet e mësipërme në çështjen konkrete, Kolegji vëren se lidhur me këto pretendime gjykatat e faktit deklarimin e fajësisë e kanë bazuar mbi një sërë provash, të tilla si: provat e administruara nga organet e drejtësisë greke, dëshmitë indirekte të shtetasve P.B., Gj.B. dhe D.Sh, dëshmitë e një sërë dëshmitarëve, të cilët kanë qenë prezentë dhe kanë dëshmuar se babai i të pandehurve, ditën e varrimit të të ndjerit, u ka dërguar fjalë të afërmeve të viktimës, duke u bërë me dije se atë e ka vrarë kërkuesi, sipas zakonit dhe rregullave të zonës për gjakmarrjen ku jetonin këta shtetas, duke i vlerësuar ato në harmoni me njëra-tjetrën dhe pa u dhënë vlerë të paracaktuar, ndërsa kanë parashtruar edhe arsyet për qëndrimin e arritur prej tyre. Në këtë mënyrë, është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se autori i veprës penale vrasje me paramendim për shkak të gjakmarrjes, është kërkuesi.

33. Gjykata e apelit ka arritur në të njëjtin përfundim si gjykata e shkallës së parë, duke analizuar dhe vlerësuar të gjitha pretendimet e kërkuarit, si dhe provat në ngarkim të tij. Ndër të tjera, dërgimi i fjalës të familja e të ndjerit ditën e varrimit është vlerësuar edhe nga kjo gjykatë si provë indirekte, pasi kjo mënyrë njoftimi për kryerjen e vrasjes njihet nga e drejta zakonore.

34. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka analizuar dhe vlerësuar dispozitat procedurale penale, konkretisht nenet 154 dhe 166 të KPP-së për sa i përket “dëshmisë indirekte” dhe kërkesës për pyetje për të pandehurin, duke argumentuar në mënyrë të detajuar elementin e “dëshmisë indirekte”. Kolegji Penal ka dhënë në këtë mënyrë përgjigje të mjaftueshme, në lidhje me këtë pretendim, duke arritur në konkluzionin se vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta janë të bazuara.

35. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se nga vendimet e gjykatave të faktit nuk rezultojnë provave të shqyrtuara t’u jetë dhënë vlerë e paracaktuar, pasi ato janë vlerësuar në unitet me provat e tjera të administruara në proces. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuari është deklaruar fajtor jo vetëm mbi dëshminë indirekte, por bazuar edhe mbi një sërë provash të administruara në gjykim dhe të shqyrtuara e vlerësuar prej gjykatave në tërësi dhe se nuk rezultojnë se ato e kanë nisur gjykimin me prezumimin se kërkuari është fajtor për kryerjen e veprës penale të vrasjes me paramendim për shkak të hakmarrjes. Prandaj edhe ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

#### *Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*

36. Kërkuari ka pretenduar se personat që kanë dëshmuar janë pyetur në vitin 1999 dhe prokurori ka vendosur pushimin e çështjes. Pas 16 vjetësh, nga momenti kur është regjistruar çështja e parë, nuk mund të gjykohej për të dhëna të cilat nuk mund të kundërshtohen, pasi dëshmitarët kishin ndërruar jetë. Të pandehurit në këtë mënyrë nuk i është dhënë mundësia të kundërshtojë vërtetësinë e provave dhe përdorimin e tyre.

37. Për sa i përket këtij pretendimi, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se sipas këtij parimi çdo palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta të paraqesë çështjen e saj. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk është formale, ku palëve iu garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit gjyqësor, por edhe substanciale, duke iu dhënë mundësi të barabarta për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës tjetër, për

rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar procesin e rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 8, datë 23.02.2021; nr.34, datë 29.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi nëpërmjet mbrojtësit së tij ka marrë pjesë në seanca gjyqësore, duke iu dhënë mundësia të dëgjohet dhe të japë dëshminë e tij, të paraqesë prova dhe t'i kundërshtojë ato dhe pretendimet e paraqitura nga organi i akuzës në mënyrë të barabartë me këtë të fundit. Pamundësia e kërkuetit për të debatuar me disa prej dëshmitarëve, të cilët nuk jetonin më gjatë kohës së gjykimit, nuk e ka vënë atë në kushte të pabarabarta me organin e prokurorisë dhe nuk i ka cenuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuetit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është haptazi i pabazuar.

39. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenin 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

**Tiranë, më 28.12.2023**

**A N Ë T A R E**

**/Fiona Papajorgji/ (d.v.)**

**A N Ë T A R E**

**/Sonila Bejtja/ (d.v.)**

**K R Y E T A R E**

**/Holta Zaçaj/ (d.v.)**

Vërtetohet njësisht me origjinalin

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Eugen PAPANDILE**